



Projekti CARPO: Zhvillimi I Sistemeve te Besueshme dhe Funktionale te Policive si dhe Inkurajimi I Luftimit te Aktiviteteve Kryesore kriminale dhe Nxitja e Bashkepunimit ndermjet Policive

14 Prill 2005
Varianti Shqip

Output 1.3: Te mbështetet një përdorim më efektiv I mjeteve të posacme hetimore dhe të dhënave të inteligjencës në pajtim me standardet e të drejtave të njeriut (nën-aktiviteti 1.3.3.1)

**TRYEZË RAJONALE PËR TË DISKUTUAR
STRATEGJITË IMPLEMENTUESE SI DHE PËR TË
SHQYRTUAR NEVOJAT PËR TRAJNIM NË
FUSHËN E MASAVE TË POSACME HETIMORE**

**PROJEKT
AXHENDË**

**18-19 Maj 2005
Tiranë, Shqipëri**

Gjuhët: Gjuha shqipe, Serbo/Kroatishte dhe Anglishte [do të ketë përkthim simultan]

Pjesëmarrësit: 25; anëtarë të Grupeve të Punës për Mjetet e Posaçme Hetimore, nga të gjitha zonat e projektit. (dy officerë të lartë të policies, të specializuar në zbatimin e mjeteve të posaçme hetimore – të paktën një prej tyre të jetë specializuar në menaxhimin dhe alokimin e agjentëve të fshehtë – një prokuror prej secilës zone të projektit)

E mërkurë, 18 Maj 2005

Sesioni I paradites

(9.00 – 13.00)

- **Hapja e tryezës**
 - *Fjalët e mirëseardhjes dhe prezantimi i pjesëmarrësve;*
 - *Një përshkrim i shkurtër i aktiviteteve të CARPOs që kanë lidhje me Mjetet e Posaçme Hetimore të planifikuara për vitet 2005/2006;*
 - *Metodologjia, objektivat dhe rezultatet e pritshme të kësaj tryeze*
 -

PJESA I

- **STRATEGJITE IMPLEMENTUESE/PLAN VEPRIMET KOMBETARE NE FUSHEN E MJETEVE TE POSACME HETIMORE**
 - *Prezantim i varianteve të para të strategjive implementuese/planveprimeve për secilën zone të projektit;*
 - *Shtjellimi i secilit prezantim në këndvështrimin e shkëmbimit të përvojës dhe hapat e mëtejshëm për finalizimin e strategjive implementuese/plan veprimeve.*

Sesioni I pasdites

(14.30 – 17.00)

- **STRATEGJITE IMPLEMENTUESE/PLAN VEPRIMET KOMBETARE NE FUSHEN E MJETEVE TE POSACME HETIMORE**
 - *[vazhdimi i sesionit të mëngjesit]*
- **ARRITJA E NJE MARREVESHJEJE NE LIDHJE ME HAPAT E METEJSHEM DHE METODOLOGJINE PER TE FINALIZUAR STRATEGJITE IMPLEMENTUESE PER SECILEN ZONE TE PROJEKTIT**

PJESA II

- **SHQYRTIMI I NEVOJAVE PER TRAJNIM NE FUSHEN E MJETEVE TE POSACME HETIMORE**
 - *tour de table ne lidhje me gjendjen aktuale, të planifikuar apo të ardhshme në fushën e Mjeteve të Posaçme Hetimore, duke e vënë theksin në trajnimet që lidhen me menaxhimin dhe instalimin e agjentëve të fshehtë në secilin vend përfitues të projektit.*

E enjte, 19 Maj 2005

Sesioni I paradites

(9.00 – 13.00)

- **PRAKTIKAT E MIRA NE FUSHEN E TRAJNIMEVE NE LIDHJE ME PERDORIMIN E MJETEVE TE POSACME HETIMORE**
 - *Prezantime nga eksperte të Këshillit të Evropës, të praktikave më të mira, në lidhje me trajnimet në fushën e masave të posacme hetimore duke e vënë theksin në menaxhimin dhe instalimin e agjentëve të fshehtë;*
- **IDENTIFIKIMI DHE PERVIJIMI I PERMBAJTJES SE MODULEVE TE PERGJITHSHME PER TRAJNIMIN NE FUSHEN E MASAVE TE POSACME HETIMORE**
 - *Identifikimi i elementëve të përbashkëta (ose rajonale), të ndryshme sipas vendeve dhe të ndryshme sipas grupeve që do të trajnohen (policë, prokurorë, gjyqtarë) të moduleve të trajnimit*

Sesioni I pasdites

(14.30 – 18.00)

- **IDENTIFIKIMI DHE PERVIJIMI I PERMBAJTJES SE MODULEVE TRAJNUESE NE LIDHJE ME MENAXHIMIN DHE INSTALIMIN E AGJENTEVE TE FSHEHTE**
 - *Identifikimi i elementëve të përbashkët, (ose rajonalë) të ndryshme sipas vendeve, si dhe të ndryshme sipas grupeve që do të trajnohen (agjentët e fshehtë, menaxhuesit e tyre), etj*
- **IDENTIFIKIMI I INSTITUCIONEVE TE AFTA PER TRAJNIM**
 - *Identifikimi në secilën prej zonave të projektit të institucioneve përkatëse që kanë mundësinë të përfshijnë në kurrikulën e tyre këto module trajnuese dhe t'i zbatojnë ato*
- **PERFUNDIMET**
 - *Rrahja e mendimeve dhe arritja e pëlqimit në lidhje me metodologjinë në hartimin dhe ndërtimin e moduleve trajnuese;*
 - *Disutime në lidhje me shpërndarjen e roleve dhe të detyrimeve në procesin e hartimit të materialeve trajnuese*

* * *

UDHEZIME PER PJESEMARRESIT

Në këtë tryezë do të jetë e domosdoshme pjesëmarrja aktive e pjesëmarrësve dhe përmbushja e objektivave të saj, kushtëzohet nga përgatitja paraprake e tyre në lidhje me tematikën e këtij seminari – anëtarët e grupeve të punës mbi mjetet e posaçme hetimore

PJESA 1

Objektivi i pjesës së parë të kësaj tryeze do të jetë të paraqesë dhe të shtjellojë, me ndihmën e një shkëmbimi rajonal të përvojave, dhe kontributeve të ekspertëve të Këshillit të Evropës, një variant të parë të strategjive implementuese /plan veprimeve mbi mjetet e posaçme hetimore, të cilën të gjitha grupet e punës në të gjitha vendet e projektit, duhet ta kenë përgatitur në kuadër të Projektit CARPO. Tryeza do t'i ndihmojë grupet e punës për të finalizuar draft strategjitë deri në 30 Maj 2005, para zhvillimit të Konferencës ndërministrare.

Gjatë tryezës secilit prej grupeve të punës do t'i kërkohet që të paraqesë elementët kryesorë të strategjisë së tyre / të plan veprimeve. Secili prej prezantimeve duhet të zgjasë maksimumi 15 min. Pas secilit prezantim, fjala do t'u jepet të gjithë pjesëmarrësve dhe të anëtarëve të panelit të ekspertëve për sugjerimet dhe komentet e tyre.

Për të përmbushur objektivat e pjesës së parë të seminarit është thelbësore që anëtarët e grupeve të punës të përgatiten paraprakisht për seminarin si dhe në lidhje me paraqitjen e një projekt-strategjie implementuese. Prezantimi nuk duhet të përqendrohet në përshkrimin e kuadrit ligjor dhe institucional ekzistues, sepse një gjë e tillë është bërë tashmë në përgjigjet e pyetësorit të hartuara para vizitës studimore në Ljublani të dhjetorit 2004. Përkundrazi, **prezantimi dhe projekt strategjia implmentuese / plan veprimi duhet të përqendrohen qartazi në identifikimin e boshllëqeve ekzistuese dhe të të planeve që do të përmbajnë hapa riparues, tek nevojat për përmirësim apo reforma, duke bërë një vlerësim të nevojave përkrah secilit parametër dhe nën-parametër të Objektivit 1.3, që janë miratuar në kuadër të Projektit CARPO.**

Ne i nxisim fuqimisht grupet e punës që të paraqesin tek ekipi drejtues i Projektit CARPO (nëpërmjet zyrave lokale të këtij projekti) një kopje të projekt-strategjisë implementuese që ata do të paraqesin në seminar me qëllim që ne t'i përkthejmë ato në të gjitha gjuhët lokale.

PJESA II

Objektivi I pjesës së dytë të seminarit konsiston në shqyrtimin e nevojave për trajnim si dhe të mundësive që ekzistojnë në këtë drejtim në fushën e mjeteve të posaçme hetimore, duke e vënë theksin tek caktimi dhe menaxhimi I agjentëve të infiltruar si dhe në arritjen e një marrëveshjeje në lidhje me elementët e përbashkët për të gjitha shtetet dhe të veçantë sipas shteteve, që duhet të përfshihen në modulet e trajnimit.

Përfundimet e këtij seminari do të jenë një udhërrëfyes për aktivitetet e mëvonshme të Projektit CARPO në fushën e mjeteve të posaçme hetimore, që do të zhvillohen në vitet 2005 dhe 2006, të cilat do të konsistojnë në përzgjedhjen e një grupi që do të trajnohet (oficerë policie të specializuar, agjentë të fshehtë dhe menaxherët e tyre, prokurorë, gjyqtarë, etj) si dhe në hartimin e moduleve trajnuese, të secilës zone në fushën e Mjeteve të Posaçme Hetimore, në zbatimin e të paktën një aktiviteti me karakter trajnues për trajnerët e ardhshëm në secilën zone të projektit, si dhe në publikimin në gjuhën vendase të materialeve trajnuese.

Për të përmbushur objektivat e pjesës së dytë të seminarit, është themelore që anëtarët e grupeve të punës të jenë në gjendje para zhvillimit të seminarit të:

- Identifikojnë trajnimet ekzistuese, të planifikuara apo të nevojshme në fushën e Mjeteve të Posaçme Hetimore (për të gjitha kategoritë relevante: officerë policie të specializuar, agjentë të fshehtë, dhe menaxherët e tyre, prokurorë, gjyqtarë etj);
- Të tregojnë institucionin (institucionet) në zonat e projektit, të cilat do të mund të përfshinin në kurrikulën e tyre këto module trajnuese si dhe t'i zbatonin ato në raport me grupe të ndryshme të përzgjedhura për trajnim;
- Të sugjerojnë personat dhe institucionet që janë në gjendje të marrin pjesë në procesin e hartimit dhe të përzgjedhjes së materialeve trajnuese specifike për secilën zone të projekt